



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI I PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Nr. 1351/12 prot.

Tiranë, më 28.05.2026

VENDIM

Nr. 48, datë 28.05.2026

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 21, DATË 26.03.2026 "PËR MIRATIMIN E
SKEDAVE PËR FITIMIN E TITULLIT "PROFESOR" DHE "PROFESOR I
ASOCIUAR"

Në bazë të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 112, datë 23.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 18.12.2019 "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm dhe Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", Vendimit nr. 100, datë 03.10.2025 të Senatit Akademik "Për disa shtesa në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm dhe Promovimin e Personelit Akademik, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", Vendimit nr. 21 datë 26.03.2026 të KPPPA-së "Për miratimin e skedave për fitimin e titullit "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar"", Urdhrit nr. 36, datë 30.04.2026 të Rektorit "Për lëshimin e vërtetimit të punësimit për kategoritë e personelit akademik dhe ndihmësakademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", Komisioni i Përherëshëm për Promovimin e Personelit Akademik, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, pas diskutimeve përkatëse;

VENDOSI:

1. Për një ndryshim në vendimin nr.21, datë 26.03.2026 "Për miratimin e skedave për fitimin e titullit "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar", sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi t'i njoftohet Rektoratit dhe njësisve kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETARI
PROF. ELIZANA ZAJMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

SKEDA PËR FITIMIN E TITULLIT "PROFESOR"

I. Të dhëna për kandidatin

Emri, atësia, mbiemri		Titulli <i>Prof.Asoc.</i> (Data, Nr. i vendimit)	Datë ____ Vendim Nr. ____
Universiteti Fakulteti Departamenti		Vjetërsia në mësimdhënie	

II. Skeda e veprimtarisë

NR.	VEPRIMTARIA	KRITERI	REALIZIMI
1	Përvoja në mësimdhënie (pas gradës Doktor) në vite pune për lektorët me kohë të plotë (e dokumentuar).	8	
2	Përvoja në mësimdhënie për pedagogët me kohë të plotë (pas titullit Prof.Asoc.) në vite pune, e dokumentuar.	5	
3	Përvoja në mësimdhënie brenda vendit (pas gradës Doktor) në vite pune për personelin akademik me kohë të pjesshme, me ose pa ndërprerje (e dokumentuar). Shënim: Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 vite, por ka përvojë pune si personela akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila llogaritet: 1.5 vite kohë e pjesshme=1 vit kohë e plotë (pas gradës "Doktor")	12	
4	2 (dy) udhëheqje /bashkudhëheqje doktoraturash të përfunduara. Bashkudhëheqja duhet të jetë me personel akademik të kategorisë "Profesor", me IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe. KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE	2	

	7/1. Për personelin akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon deri në fillimin e vitit akademik 2026-2027, për titullin akademik "Profesor", kriteri i shkronjës "c", të pikës 3, të kreut III, konsiderohet i plotësuar nëse ka udhëhequr/bashkudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë, të përfunduar.		
5	1 (një) udhëheqje/bashkudhëheqje doktorature të përfunduar (kur veprimtaria akademike-shkencore është kryer pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë). Kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit.	1	
6	Referime si autor i parë, në konferenca dhe kongrese shkencore (pas titullit Prof.Asoc.)	5	
7	Referime si autor i parë, mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. (pas titullit Prof.Asoc.)	2	
8	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara (pas titullit Prof.Asoc.)	7	të shënohet numri dhe të listohen duke cilësuar artikujt me faktor impakti
9	Artikuj shkencorë, si autor i parë ose i dytë, të botuar në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Reports, faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) (pas titullit Prof.Asoc.)	3	të shënohet numri dhe të listohen duke cilësuar artikujt me faktor impakti
10	Artikuj shkencorë, si autor i parë (pas titullit Prof.Asoc.)	4	të shënohet numri dhe të listohen duke cilësuar artikujt me faktor impakti

11	Monografi shkencore, botuar në gjuhë të huaj jashtë vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112)		
12	Monografi shkencore, botuar brenda vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112)		
13	Titullar lënde ose moduli, për jo më pak se 5 vite akademike (e dokumentuar me evidenca pagese, syllabus dhe firmë e vulë të Rektorit të UMT)		
14	Angazhime dhe pjesëmarrje në veprimtaritë e përcaktuara në pikën 6, kreu III, VKM 112.		

Veprimtari të tjera të realizuara nga kandidati

(veprimtari të ndryshme mbështetese ndaj institucionit, poste drejtuese brenda institucionit ose në institucione të tjera të arsimit të lartë, studime dhe projekte, pjesëmarrje në shoqata profesioniste etj...)

Prof. Asc. Emër Mbiemër ka ushtruar ose ushtron funksionet e:

(të listohen)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

SKEDA PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR”

I. Të dhëna për kandidatin

Emri, atësia, mbiemri		Titulli <i>Doktor</i> . (Data, Nr. i vendimit)	Datë Vendim Nr.
Universiteti Fakulteti Departamenti		Vjetërsia në mësimdhënie	

II. Skeda e veprimtarisë

NR.	VEPRIMTARIA	KRITERI	REALIZIMI
1	Përvoja në mësimdhënie (pas gradës Doktor) në vite pune, për lektorët me kohë të plotë, me ose pa ndërprerje (e dokumentuar). Shënim: Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se pesë vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjeshme më të ulët se tetë vite, koha e pjeshshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila llogaritet: 1.6 vite kohë e pjeshshme=1 vit kohë e plotë	5	
2	Përvoja në mësimdhënie brenda vendit (pas gradës Doktor) në vite pune për personelin akademik me kohë të pjeshme, me ose pa ndërprerje (e dokumentuar).	8	
3	Referime si autor i parë, në konferenca dhe kongrese shkencore (pas gradës Doktor)	5	të shënohet numri dhe të listohen
4	Referime si autor i parë, mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “ <i>Proceedings</i> ”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN (pas gradës Doktor)	2	të shënohet numri dhe të listohen
5	Artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara (pas gradës Doktor)	5	të shënohet numri dhe të listohen duke cilësuar artikujt me faktor impakti
6	Artikuj shkencorë si autor i parë ose i dytë, të botuar në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi te Journal Citation Reports, faktor	2	të shënohet numri dhe të listohen duke cilësuar artikujt me faktor impakti

	impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI) (pas gradës Doktor)		
7	Artikuj shkencorë si autor i parë (pas gradës Doktor)	2	të shënohet numri dhe të listohen duke cilësuar artikujt me faktor impakti
8	Monografi shkencore, botuar në gjuhë të huaj jashtë vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112)		
9	Monografi shkencore, botuar brenda vendit (kur plotëson kushtet e përcaktuara në VKM 112)		të shënohet nëse ka
10	Të ketë zhvilluar cikël të plotë leksionesh, së paku 1 lëndë, për jo më pak se 3 vite akademike, e dokumentuar, firmosur dhe vulosur nga Rektori i UMT	1	të specifikohet
11	Angazhime dhe pjesëmarrje në veprimtaritë e përcaktuara në Pikën 7, Kreu II, VKM 112.		të listohen
12	Studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe		

I. Veprimtari të tjera të realizuara nga kandidati

(veprimtari të ndryshme mbështetëse ndaj institucionit, poste drejtuese brenda institucionit ose në institucione të tjera të arsimit të lartë, studime dhe projekte, pjesëmarrje në shoqata profesioniste etj...)